

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje nenit 9, paragrafëve 1, 2, 4 dhe 9, si dhe nenit 52, 53, 54, 55 dhe 56 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së, nr. 275, datë 30.12.2024 në ndërlidhje me nenin 18, paragrafi 4 të rregullores mbi punën e organeve kolegjiale nr. në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2026, nxjerr këtë:

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nr. 132 Datë 02/07/26

VENDIM

I. Hapet periudha e kandidimit për zgjedhjen e anëtarëve të organeve të Odës së Farmacistëve të Kosovës, përkatësisht për:

- Këshillin Drejtues;
- Këshillin Mbikëqyrës;
- Gjykatën e Nderit;
- Këshillin Etik;
- Prokurorin e Odës; dhe
- Zëvendësprokurorin e Odës.

II. Periudha e kandidimit fillon më 02 korrik 2026 dhe përfundon më 08 korrik 2026.

III. Kandidaturat dorëzohen fizikisht në zyrat e Odës së Farmacistëve të Kosovës, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në ora 15:00, me përjashtim të kohës së pauzës nga ora 12:00 deri në ora 13:00.

IV. Kandidaturat dorëzohen në formularin e miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ndërsa kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e kandidimit, si në vijim:

1. Të jetë anëtar i Kuvendit të Odës së Farmacistëve të Kosovës dhe të ketë dhënë betimin si anëtar i Kuvendit.
2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij vendimi, kandidati për funksionin e Prokurorit të Odës dhe Zëvendësprokurorit të Odës mund të kandidojë edhe nëse nuk është anëtar i Kuvendit.

3. Një kandidat nuk mund të kandidojë njëkohësisht për më shumë se një (1) funksion (Kryetar, Zëvendëskryetar ose Anëtar) në një (1) organ.
4. Në formularin e kandidimit, kandidati duhet të deklarojë qartë organin për të cilin kandidon, si dhe funksionin për të cilin paraqet kandidaturën, përkatësisht:
 - Kryetar;
 - Zëvendëskryetar; ose
 - Anëtar,

sipas strukturës dhe funksioneve të parashikuara për organin përkatës.

5. Të sigurojë mbështetjen me nënshkrim të së paku pesë (5) anëtarëve të Kuvendit, të cilët kanë përfunduar procedurën e betimit.
 6. Çdo anëtar i Kuvendit mund të japë nënshkrim mbështetës vetëm për një (1) kandidat për të njëjtin organ.
 7. Anëtari i Kuvendit nuk mund të japë nënshkrim mbështetës për kandidaturën e tij/saj.
 8. Kandidati është i detyruar të dorëzojë formularin e kandidimit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), të plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara.
 9. Kandidatura konsiderohet e vlefshme vetëm nëse dokumentacioni i kërkuar është i plotë dhe dorëzohet brenda afatit të përcaktuar me këtë vendim.
- V. Formulari i kandidimit si dhe rregullat zgjedhore janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe publikohet në faqen zyrtare të Odës së Farmacistëve të Kosovës.

Përdërgohet :

- Anëtarëve të Kuvendit
- Sekretariatit të KQZ-së
- Për publikim në web

Kryetari i KQZ-së

per Mr.Ph. Betim Ramadani



Rregullat e sjelljes zgjedhore gjatë periudhës zgjedhore

Të gjithë kandidatët, anëtarët e Kuvendit të Odës së Farmacistëve të Kosovës, mbështetësit e kandidatëve dhe vëzhguesit njoftohen se gjatë periudhës zgjedhore janë të obliguar të respektojnë Rregullat dhe Standardet e Sjelljes Zgjedhore, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Odës së Farmacistëve të Kosovës (KQZ)

Gjatë periudhës së kandidimit, mbledhjes së nënshkrimeve mbështetëse, fushatës zgjedhore dhe ditës së votimit, të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor janë të obliguar të veprojnë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, barazisë, transparencës, paanshmërisë, etikës dhe integritetit të procesit zgjedhor.

Ndalohet çdo veprim që cenon lirinë e kandidimit, lirinë e votimit, fshehtësinë e votës ose rregullsinë e procesit zgjedhor. Në veçanti, ndalohet:

- ushtrimi i presionit, ndikimit të padrejtë, kërcënimit ose kushtëzimit ndaj kandidatëve ose anëtarëve të Kuvendit;
- sigurimi i nënshkrimeve mbështetëse përmes mashtrimit, detyrimit dhe presionit ose premtimit të përfitimeve të paligjshme;
- pengimi ose ndërhyrja në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) apo organet e tij;
- qëndrimi pa autorizim në hapësirën ku zhvillohet votimi ose pengimi i zhvillimit normal të procesit zgjedhor;
- kërcënimi, fyerja ose intimidimi i kandidatëve, anëtarëve të Kuvendit ose vëzhguesve;
- votimi më shumë se një herë ose votimi në emër të një personi tjetër;
- përdorimi i gjuhës fyese, diskriminuese, kërcënuese ose nxitëse të urrejtjes;
- ndërhyrja në procesin e votimit, numërimit, administrimit ose ruajtjes së materialit zgjedhor; dhe
- çdo veprim tjetër që cenon ligjshmërinë, rregullsinë, transparencën ose besueshmërinë e procesit zgjedhor.

Vëzhguesit kanë të drejtë të përcjellin procesin zgjedhor vetëm në përputhje me autorizimin e lëshuar nga KQZ. Vëzhguesve u ndalohet ndërhyrja në procesin zgjedhor, ndikimi të anëtarët e Kuvendit ose pengimi i mbarëvajtjes së votimit dhe numërimit të votave.

Çdo pretendim për shkelje të këtyre rregullave paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), jo më vonë se njëzet e katër (24) orë nga momenti i pretendimit për shkelje. Ankesa duhet të përmbajë përshkrimin e qartë të shkeljes së pretenduar dhe, kur është e mundur, të shoqërohet me provat përkatëse.

Në rast të konstatimit të shkeljeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sipas kompetencave të tij, mund të ndërmarrë ose të iniciojë masat përkatëse, duke përfshirë paralajmërimin, diskualifikimin e kandidatit nga procesi zgjedhor, iniciimin e procedurave etike ose disiplinore, si dhe procedura të tjera të parapara me legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të OFK-së.